

## Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa për Stafin Administrativ të UST-së në Universitetin e Romës “Foro Italico”

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për stafin administrativ të Universitetit të Sporteve të Tiranës në Universitetin e Romës “Foro Italico”

### Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Stafi administrativ për trajnim;

### Kohëzgjatja e mobilitetit:

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

### Mobiliteti përfshin:

- Kompensimin ditor 140 Euro;

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### Dokumentet e nevojshme për aplikim për staf Administrativ për trajnim:

- CV (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze

- Vërtetim nga Kancelari i Universitetit tuaj që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.

Afati për aplikim: **13 Janar 2017**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi pranë Zyrës së Protokollit në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën [sshabanaj@ust.edu.al](mailto:sshabanaj@ust.edu.al)

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Teknologjisë së informacionit në adresën: [sshabanaj@ust.edu.al](mailto:sshabanaj@ust.edu.al)

Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!